

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Bardhi pas deklaratës së Ramës për Hysenin: Dil dhe jep llogari - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/bardhi-pas-deklarates-se-rames-per-hysenin-dil-dhe-jep-llogari/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 10:18:03 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 10:14:40 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	65e7f9fb06cc7f9e801a0ec1b2589511caff82322369d6852952af9dfc446677
TEKSTI	93eda9b83ff5ac6a2631b1931055cba6049c048ce50bbf710fc15edca355fbf9
PAMJA	4a29ea1f7fcbd07f723e9d213bd362401d444025f415bad1dec06034300a9aa6

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	23f962d3aa95afe81c980f2f8f1cd240da0bd9d07e17fd65100753183aa713b3
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	abea285c66b625fda61d55a4ce47e92e047f4e5aa34cb0aedb7a5ee71b2cb2e0
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/23f962d3aa95afe81c980f2f8f1cd240da0bd9d07e17fd65100753183aa713b3>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Edi Rama SHBA Pagat e gjyqtarëve Rusia Maliq

POLITIKË | VENDI

Bardhi pas deklaratës së Ramës për Hysenin: Dil dhe jep llogari

28 Shtator 2026 | 12:14

Kreu i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Gazment Bardhi, ka reaguar pas deklaratave të kryeministrit Edi Rama për zhvillimet e fundit në vend, duke kërkuar prej tij përgjigje për një sërë çështjesh që lidhen me qeverisjen dhe institucionet shtetërore.

Në një deklaratë të gjatë për mediat, Bardhi u ndal veçanërisht te çështja e ish-drejtores së SHISH, Vlora Hyseni, dhe emërimi i saj në krye të këtij institucioni.

Rama ka deklaruar se Hyseni kishte marrë "referenca të shkëlqyera nga partnerët" përpara emërimit në krye të SHISH. Bardhi kërkoi që kryeministri të bëjë publikë emrat e këtyre partnerëve.

"Dil dhe tregoj shqiptarëve cili shërbim i huaj, cili partner ndërkombëtar ta sugjeroi Vlora Hysenin me referencë të shkëlqyer dhe kush është shastisur nga veprimet ligjore të SPAK kundër krimeve të saj?", tha Bardhi.

Ai kërkoi gjithashtu shpjegime për të kaluarën e Hysenit në institucionet e sigurisë në Kosovë dhe për mënyrën se si ajo u përzgjedh për të drejtuar SHISH.

"Dil gjithashtu dhe na trego, çfarë u verifikua lidhur me shkarkimin e saj nga pozicionet drejtuese në Shërbimin Informativ të Kosovës, me vendim të Kryeministrit Albin Kurti dhe Presidentes Vjosa Osmani? A keni një përgjigje, zoti Kryeministër?", u shpreh ai.

Bardhi ngriti pyetje edhe për akuzat që lidhen me marrëdhëniet e Hysenit me personin nën hetim Ergys Agasi.

"Kush e vuri, Vlora Hysenin në shërbim të Ergys Agasit? A keni një përgjigje, zoti Kryeministër?", deklaroi kreu i grupit parlamentar të PD-së.

Sipas Bardhit, opozita i kishte ngritur më herët këto pretendime në Kuvend dhe në komisionet parlamentare, ndërsa kërkoi të dijë nëse kryeministri kishte urdhëruar verifikimin e tyre.

"Çfarë masash ka marrë Kryeministri për të verifikuar këto akuza të opozitës? A mund të kemi një përgjigje, zoti Kryeministër?", pyeti Bardhi.

Një pjesë tjetër e deklaratës së tij iu kushtua mënyrës se si Rama ka reaguar ndaj zyrtarëve që janë përballur me drejtësinë. Bardhi përmendi disa raste, mes tyre çështjet e dekriminalizimit, ish-ministrit Saimir Tahiri, koncesioneve në shëndetësi dhe inceneratorëve.

Duke iu referuar inceneratorëve, Bardhi tha se opozita kishte ngritur më herët pretendime për parregullsi dhe akuzoi kryeministrin se kishte mbështetur projektet.

LAJMI I FUNDIT

12:09 **Kremlini: Ukraina po paguan çmimin për sulmet ndaj Rusisë**

12:04 **Debate te "Ligjet" për Territorialen! PD kërkon 100 bashki, PS 46, Korreshi: Nuk po bëjë byrek këtu**

12:01 **Parlamenti hungarez i heq SHPËRNDAJË munitetin Peter Magyar dhe dy ARTIKULLIN ish-ministrave të Orban**

11:47 **Protestë në Maliq, banorët: Po na marrin ujin për fshatin tjetër**

11:46 **Vrasja e Egli Progës, të akuzuarit kërkojnë gjykim të shkurtuar! Shtyhet për në tetor seanca**

11:43 **Mashtruan 64-vjeçarën për 100 mijë euro, dy të rinj kapen në flagrancë teksa merrnin paratë**

TESTIM

“A nuk ishte ti Edi Rama garant që inceneratorët ekzistonin, punonin dhe dignin çdo ditë plehurat e shqiptarëve? A nuk ishte ti që firmose 17 vendime brenda ditës për t’i hapur rrugë një skeme që i kushtoi shqiptarëve 340 milionë euro?”, deklaroi Bardhi.

Ai u ndal edhe te tenderat e AKSHI-t dhe kërkoi nga kryeministri shpjegime për akuzat e bëra publike në lidhje me këtë institucion.

“Dil dhe shpjegoju shqiptarëve: ka pasuri Linda e AKSHI-t apo jeton me qira, siç na the ti? Pse hesht tani?”, tha Bardhi.

Në deklaratën e tij, kreu i grupit parlamentar të PD-së përmendi edhe KAYO-n, Portin e Durrësit, Tunelin e Llogarasë dhe Aeroportin e Vlorës, duke ngritur pyetje mbi mënyrën e përzgjedhjes së kompanive dhe partnerëve në këto projekte.

“Po Alabari, si e fitoi truallin mbi Portin e Durrësit? Me konkurs apo me ligj special dhe me përzgjedhje personale tënden?”, pyeti Bardhi.

Ai kërkoi gjithashtu shpjegime për përzgjedhjen e kompanive turke në projektet e Tunelit të Llogarasë dhe Aeroportit të Vlorës.

Bardhi foli edhe për marrëdhëniet mes qeverisë dhe medias, duke përmendur sulmet e Ramës ndaj Syri TV dhe News 24.

“Një Kryeministër i përgjegjshëm nuk shantazhon mediat. Nëse ai ka dijeni për një krim, ka detyrimin ligjor t’u drejtohet organeve të drejtësisë”, deklaroi ai.

Sipas Bardhit, përgjegjësia penale duhet të përcaktohet nga drejtësia, ndërsa qeveria duhet të japë llogari për vendimmarrjen politike dhe mënyrën e funksionimit të institucioneve.

“Përgjegjësia penale është çështje e drejtësisë. Ndërsa, përgjegjësia politike është çështje e llogaridhënies publike. Dhe transparenca ndaj qytetarëve është detyrim i çdo qeverie”, u shpreh ai.

Në fund të deklaratës, Bardhi i kërkoi kryeministrit të japë përgjigje për emërimet, tenderat, koncesionet dhe marrëdhëniet mes pushtetit, biznesit dhe institucioneve.

“Këto janë pyetjet që kërkojnë përgjigje. Përgjigje për mënyrën se si janë bërë emërimet. Përgjigje për mënyrën se si janë dhënë tenderat dhe koncesionet. Përgjigje për mënyrën se si janë mbikëqyrur institucionet. Përgjigje për marrëdhëniet mes pushtetit dhe biznesit. Përgjigje për marrëdhëniet mes pushtetit dhe kimit”, tha Bardhi.

Deklaratën e tij ai e mbylli me kërkesën për dorëheqjen e kryeministrit.

“Edi Rama, dil dhe jep llogari”, deklaroi Bardhi, duke shtuar: “Përgjegjësia e parë që të takon ty, Edi Rama, është politike. Jep dorëheqjen!”

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

POLITIKË | VENDI

Debate te “Ligjet” për Territoriale! PD kërkon 100 bashki, PS 46, Korreshi: Nuk po bëmë byrek këtu

Komisioni i Ligjeve ka nisur shqyrtimin e nismës për hartën e re territoriale të vendit, me Partinë Socialiste që kërkon të ecë përpara me variantin...

12:04 | 28/09/2026

AKTUALITET | LAJM KRYESOR | POLITIKË | VENDI

Ambasadorja e BE: Një demokraci nuk vlerësohet vetëm si bëhen zgjedhjet, por dhe te roli i Kuvendit

Ambasadorja e BE, Sofia Moreira De Sousa ka mbajtur këtë të hënë fjalën e saj në konferencën Ndërparlamentare mes përfaqësues të institucioneve shqiptare, Parlamentit European...

11:35 | 28/09/2026

LAJM KRYESOR | POLITIKË | VENDI

“Luaj me gangsterin rus apo me lodrat kineze?”, Rama: Vendet kandidate duhet të jenë rreth tavolinës së BE-së

Kryeministri Edi Rama ka kërkuar që Bashkimi European të marrë në kohë vendimet politike për zgjerimin, ndërsa vlerësimi i secilit vend kandidat të vijojë më...

11:26 | 28/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni
Punësimi

Follow Euronews on all platforms:

Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.